




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 30, paragrafit 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.24 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 56 paragrafi 2 dhe 3, neni 57 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 62 paragrafi 4 të Rregullores Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27 dhjetor 2023,

Miraton:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 06/2023
PËR PROCEDURAT PËR KOMPENSIMIN E MBROJTËSVE ME
SHPENZIME PUBLIKE**

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktoj kriteret dhe procedurën për caktimin e avokatit mbrojtës me shpenzime publike në çështjet penale si dhe lartësinë e kompensimit, në të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ zbatohen ndaj të gjithë avokatëve mbrojtës me shpenzime publike të caktuar nga gjykatat e Republikës së Kosovës, si dhe nga zyrtarët ligjor/sekretarët juridik të gjykatave/degëve, zyrtari financiar i gjykatës/arkëtari i degës përkatëse dhe administratori/ndihmës administratori i gjykatës/degës përkatëse.

2. Zbatimi i këtij udhëzimi administrativ nga zyrtarët përgjegjës të gjykatave/degëve, siç përcaktohet me paragrafin 1 të këtij neni kryhet me mbështetjen e Departamentit për Buxhet dhe Financa të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Neni 3

Avokati mbrojtës me shpenzime publike

Për qëllime të këtij udhëzimi termi avokat mbrojtës me shpenzime publike nënkupton avokatin e regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës, të caktuar nga gjykata për përfaqësimin e të pandehurit në çështje penale për rastet e parapara me nenin 4 të këtij udhëzimi.

Neni 4

Kriteret për caktimin e avokatit mbrojtës me shpenzime publike

1. Gjkata të pandehurit mund t'i caktojë avokat mbrojtës me shpenzime publike për rastet si në vijim:

- 1.1. sipas detyrës zyrtare në rastet e mbrojtjes së detyrueshme të parapara sipas nenit 56 të Kodit të Procedurës Penale;
- 1.2. me kërkesë të të pandehurit për rastet e parapara sipas nenit 57 paragrafi 1, nënparagrafët 1.1, 1.2 pika 1.2.2, të Kodit të Procedurës Penale, nëse nuk janë plotësuar kushtet e mbrojtjes së detyrueshme.

KAPITULLI II

KOMPENSIMI DHE LARTËSIA PËR SHËRBIME TË AVOKATIT MBROJTËS ME SHPENZIME PUBLIKE

Neni 5

Kompensimi i avokatit mbrojtës me shpenzime publike

1. Avokati mbrojtës me shpenzime publike i caktuar nga gjykata për përfaqësimin e të pandehurit në procedurë penale do të kompensohet për:

- 1.1. shqyrtimin e shkresave, përfaqësimin e të pandehurit në gjykatë, vizitën e të pandehurit në paraburgim apo entin shëndetësor;
- 1.2. përpilimin e mjeteve të rregullta juridike, ankesa kundër aktvendimit, kundërshtimi i provave dhe kërkesa për hedhje të aktakuzës, kundërshtimi ndaj urdhrin të gjyqtarit të procedurës paraprake, dhe ankesa kundër aktgjykimit në përputhje me nenin 374 të Kodit të Procedurës Penal;
- 1.3. përpilimin e mjeteve të jashtëzakonshme juridike në rastet sipas nenit 56 nënparagrafi

1.4 dhe nenit 432 paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 6

Lartësia e kompensimit për shqyrtimin e shkresave

1. Për shqyrtimin e shkresave, në Departamentin e Përgjithshëm, avokatit mbrojtës me shpenzime publike i takon kompensimi në vlerë prej njëzet (20) €.
2. Për shqyrtimin e shkresave në rastet që janë në kompetencë të Departamentit Special, Departamentit për Krime të Rënda dhe në Departamentin për të Mitur, avokatit mbrojtës me shpenzime publike i takon kompensimi në vlerë prej dyzet (40) €.
3. Në rast të ndërrimit të mbrojtësit sipas detyrës zyrtare të gjitha shkresat nga mbrojtësi paraprak barten tek mbrojtësi i ri.
4. Për shqyrtimin e shkresave, mbrojtësi kompensohet vetëm njëherë.

Neni 7

Lartësia e kompensimit për përfaqësimin e të pandehurit

1. Për mbrojtjen e të pandehurit në seancë pranë Departamentit Special, Departamentit për Krime të Rënda, Departamentit për të Mitur dhe Departamentin e Përgjithshëm, avokatit mbrojtës me shpenzime publike i takon kompensimi si në vijim:
 - 1.1. për vepër penale për të cilën parashihet dënimi deri në tri (3) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej dyzet (40) €;
 - 1.2. për vepër penale për të cilën parashihet dënimi deri në pesë (5) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej pesëdhjetë (50) €;
 - 1.3. për vepër penale për të cilën parashihet dënimi deri në dhjetë (10) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej shtatëdhjetë (70) €;
 - 1.4. për vepër penale për të cilën parashihet dënimi deri në njëzet (20) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej njëqind (100) €;
 - 1.5. për vepër penale që parashihet dënimi me burgim mbi njëzet (20) vite burgim apo dënimi me burgim të përjetshëm, i takon kompensimi në vlerë prej njëqind e pesëdhjetë (150) € të shumës së përcaktuar me tarifën e avokatëve.
2. Për mbrojtjen e të pandehurit në seancën që zgjatë më shumë se një (1) orë, avokatit mbrojtës me shpenzime publike i takon kompensimi plotësues. Për çdo orë shtesë të prezencës në seancë, avokatit mbrojtës me shpenzime publike i takon +30% e kompensimit të përcaktuar me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Nëse seanca nuk mbahet, shtyhet apo ndërpritet për të vazhduar për një ditë tjetër pa fajin e mbrojtësit, në këtë rast avokatit mbrojtës me shpenzime publike i takon kompensimi në vlerë prej 50% e shumës së përcaktuar me paragrafin 1 të këtij neni.

4. Nëse seanca nuk fillon me kohë, pa fajin e avokatit mbrojtës me shpenzime publike, çdo orë e prezencës së avokatit mbrojtës me shpenzime publike në gjykatë kompensohet me 40% të vlerës së përcaktuar me paragrafin 1 të këtij neni. Pagesa për kompensim i takon vetëm në rastet kur vonesa ka qenë tridhjetë (30) minuta apo më shumë. Për efekt të kompensimit, koha prej tridhjetë (30) minuta apo më tepër llogaritet si një (1) orë.

Neni 8

Lartësia e kompensimit për përpilimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike

1. Për përpilimin e ankesës kundër aktvendimit, kundërshtimit ndaj urdhrorit të gjyqtarit të procedurës paraprake, kundërshtimit të provave dhe kërkesës për hedhjen e aktakuzës, avokatit mbrojtës me shpenzime publike i takon kompensimi si në vijim:

- 1.1. për vepër penale ku parashihet dënimi deri në 3 (tri) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej dyzet (40) €;
- 1.2. për vepër penale ku parashihet dënimi deri në pesë (5) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej pesëdhjetë (50) €;
- 1.3. për vepër penale ku parashihet dënimi deri në dhjetë (10) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej shtatëdhjetë (70) €;
- 1.4. për vepër penale ku parashihet dënimi mbi dhjetë (10) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej njëqind (100) €.

2. Për përpilimin e mjetit të jashtëzakonshëm, kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur, kundër aktvendimit për caktimin apo vazhdimin e paraburgimit sipas nenit 432 paragrafit 4 të Kodit të Procedurës Penale, avokatit mbrojtës me shpenzime publike i takon kompensimi si në vijim:

- 2.1. për vepër penale ku parashihet dënimi deri në dhjetë (10) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej pesëdhjetë (50) €;
- 2.2. për vepër penale ku parashihet dënimi mbi dhjetë (10) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej nëntëdhjetë (90) €.

3. Për përpilimin e ankesës kundër aktgjykimit, dhe mjeteve të jashtëzakonshme juridike, kundër aktgjykimit vetëm në rastet që parashihen me nenin 56 nënparagrafin 1.4 të KPPK, avokatit mbrojtës me shpenzime publike i takon e drejta e kompensimit si në vijim:

- 3.1. për vepër penale ku parashihet dënimi deri në tri (3) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej tetëdhjetë (80) €;
- 3.2. për vepër penale ku parashihet dënimi deri në pesë (5) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej nëntëdhjetë (90) €;

- 3.3. për vepër penale ku parashihet dënimi deri në dhjetë (10) vite burgim, i takon kompensimi në shumë prej njëqind e tridhjetë (130) €;
- 3.4. për vepër penale ku parashihet dënimi deri në njëzet (20) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej njëqind e pesëdhjetë (150) €;
- 3.5. për vepër penale ku parashihet dënimi mbi njëzet (20) vite burgim apo dënim me burgim të përjetshëm, i takon kompensimi në vlerë prej njëqind e gjashtëdhjetë (160) €.

Neni 9

Lartësia e kompensimit për vizitat e të pandehurit në paraburgim apo në entin shëndetësor

1. Për vizitën e të pandehurit në paraburgim apo në entin shëndetësor, avokatit mbrojtës me shpenzime publike i takon kompensimi si në vijim:

- 1.1. për vepër penale për të cilën parashihet dënimi deri në tri (3) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej dyzet (40) €;
- 1.2. për vepër penale për të cilën parashihet dënimi deri në pesë (5) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej pesëdhjetë (50) €;
- 1.3. për vepër penale për të cilën parashihet dënimi deri në dhjetë (10) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej shtatëdhjetë (70) €;
- 1.4. për vepër penale për të cilën parashihet dënimi deri në njëzet (20) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej njëqind (100) €;
- 1.5. për vepër penale që parashihet dënimi me burgim mbi njëzet (20) vite burgim, apo dënimi me burgim të përjetshëm, i takon kompensimi në vlerë prej njëqind e pesëdhjetë (150) € të shumës së përcaktuar me tarifën e avokatëve.

2. Kompensimi i cekur sikurse në paragrafin 1 të këtij neni i takon njëherë në muaj nëse është caktuar seanca dhe duhet të vërtetohet me lejen për vizitën e lëshuar nga ana e gjykatës kompetente.

KAPITULLI III

PROCEDURA PËR KOMPENSIMIN E AVOKATIT MBROJTËS ME SHPENZIME PUBLIKE

Neni 10

Dokumentet e nevojshme për realizimin e kompensimit

1. Avokati mbrojtës me shpenzime publike i angazhuar për herë të parë për realizimin e kompensimit është i obliguar që në gjykatë të dorëzojë këto dokumente:

- 1.1. certifikata e regjistrimit të biznesit/avokaturës;

- 1.2. certifikatën e numrit fiskal;
- 1.3. kopjen e llogarisë në emër të biznesit/avokaturës;
- 1.4. kopjen e letërnjoftimit;
- 1.5. kopjen e kratelës identifikuese valide të lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës.

Neni 11

Formulari për Kompensim

1. Administratori/ndihmës administratori i gjykatës/degës përkatëse, varësisht nga organizimi i gjykatës e cakton zyrtarin për pranimin e formularit për kompensimin të avokati mbrojtës me shpenzime publike.
2. Avokati mbrojtës me shpenzime publike pas përfundimit të seancës, apo pas dorëzimit të mjetit juridik, siç parashihet me këtë udhëzim administrativ, përmes zyrtarit për pranimin sipas paragrafit 1 të këtij neni e dorëzon formularin për kompensimin në gjykatën/degën përkatëse.
3. Zyrtari/ja për pranim sipas paragrafit 1 të këtij neni, pas pranimit të formularit për kompensim në bashkëpunim me zyrtarin/en ligjor/e apo sekretarin/en juridik/e të gjyqtarit të lëndës në gjykatë/degë, verifikon saktësinë e të dhënave dhe ia paraqet gjyqtarit të çështjes për nënshkrim.
4. Në formularin për kompensimin e mbrojtësit për përfaqësim në seancë, duhet të shënohet me saktësi koha fillimit dhe përfundimit të seancës, duke u bazuar në procesverbalin e seancës përkatëse.
5. Formulari për kompensim bëhet në tri (3) kopje dhe nënshkruhet nga gjyqtari i vetëm, kryetari i trupit gjykues/kolegjit, në gjykatën/degën përkatëse. Një kopje e formularit të plotësuar mbetet në lëndë, ndërsa dy (2) kopje i dorëzohen avokatit mbrojtës me shpenzime publike përmes zyrtarit për pranimin e formularit për kompensim, për të përgatitur faturën mujore.

Neni 12

Fatura

1. Fatura e cila lëshohet nga avokati mbrojtës me shpenzime publike, për të qenë valide për gjykatën duhet t'i përmbajë këto të dhëna:
 - 1.1. numrin e faturës;
 - 1.2. datën e faturës;
 - 1.3. emrin e lëshuesit të faturës (emri i biznesit/avokaturës);
 - 1.4. numrin e llogarisë në emër të avokaturës – biznesit;
 - 1.5. numrin fiskal të biznesit;
 - 1.6. emrin e gjykatës/degës;
 - 1.7. specifikacionin sipas numrit të lëndës;
 - 1.8. e nënshkruar dhe vulosur (vula duhet të jetë në emër të avokaturës/biznesit);
 - 1.9. e pastër dhe jo e përmirësuar.

Neni 13
Procedura për realizimin e kompensimit

1. Fatura e plotësuar dhe e nënshkruar nga avokati mbrojtës me shpenzime publike sipas nenit 12 të këtij udhëzimi administrativ, pasi të evidentohet nga zyrtari i pranimit të formularit për kompensimin në gjykatë/degë përkatëse i dorëzohet zyrës së financave.
2. Dorëzimi i dokumentacionit nga avokati mbrojtës me shpenzime publike për muajin paraprak detyrimisht bëhet nga data një (1) deri me datë njëzet (20) të muajit vijues.
3. Zyrtari financiar i gjykatës përkatëse pas kontrollimit dhe verifikimit të të dhënave të formularit me faturë përgatit tabelën përmbledhëse, e cila nënshkruhet nga administratori/ndihmës administratori i gjykatës/degës.
4. Pas kompletimit të dokumentacionit për pagesë, zyra e financave në gjykatën përkatëse bën ekzekutimin e pagesave brenda afateve të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.
5. Në rastet kur eventualisht nuk respektohen afatet sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni për dorëzimin e dokumentacionit për kompensim, zyra e financave në gjykatë nuk do ta realizojë pagesën përkatësisht kompensimin.

Neni 14
Dispozitat kalimtare

Këshilli për çdo vit kalendarik i rishikon tarifat për kompensimin e mbrojtësve me shpenzime publike.

Neni 15
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrative nr.09/2014 për Procedurat për Kompensimin e Mbrojtësve me Shpenzime Publike, dhe të gjitha dispozitat e tjera të akteve të miratuara në Këshill, e që mund të bien në kundërshtim me këtë udhëzim administrativ.

Neni 16
Shtojca

1. Shtojca që i është bashkangjitur këtij udhëzimi administrativ është pjesë përbërëse e tij:
 - 1.1. Formulari për kompensimin e avokatit mbrojtës me shpenzime publike.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë: 28. 12. 2023



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA

FORMULARI PËR KOMPENSIMIN E AVOKATIT MBROJTËS ME SHPENZIME PUBLIKE

Gjykata			Dega		
Departamenti		Nr.i Lëndës		Koha e fillimit të seancës	
Emri dhe mbiemri i mbrojtësit		Emri dhe mbiemri i të akuzuarit		Koha e përfundimit të seancës	

Pjesa I. – Shqyrtimi i shkresave¹

Departamenti	Vlera	Data e shqyrtimit të shkresave	Shkresat e shqyrtuara	Vërejtje
Departamenti i Përgjithshëm	20 EUR			
Departamenti Special	40 EUR			
Departamenti i Krimeve të Rënda	40 EUR			
Departamenti për të Mitur	40 EUR			

Vërejtje - Për shqyrtimin e shkresave, mbrojtësi kompensohet vetëm një herë.

Pjesa II – Përfaqësimi i të pandehurit²

Departamenti	Përshkrimi i llojit të veprës	Çmimi/Shuma (EUR)	Data e seancës	Prej – deri (orët)	Totali i orëve	Pagesë për orë: ora e parë në Gjykatë (EUR)	Pagesa për orët shtesë në Gjykatë (30%)
Departamenti Special, Departamenti i Krimeve të Rënda, Departamenti për të Mitur, Departamenti i Përgjithshëm.	Për veprë penale për të cilën parashihet dënimi deri në tri (3) vite burgim	40					
	Për veprë penale për të cilën parashihet dënimi deri në pesë (5) vite burgim	50					
	Për veprë penale për të cilën parashihet dënimi deri në dhjetë (10) vite burgim	70					
	Për veprë penale për të cilën parashihet dënimi deri në njëzet (20) vite burgim	100					
	Për veprë penale për të cilën parashihet dënimi mbi njëzet (20) vite burgim	150					

Nëse seanca nuk mbahet (shtyhet apo ndërpritet për të vazhduar për një ditë tjetër) pa fajin e mbrojtësit, në këtë rast avokatit mbrojtës i takon kompensimi në vlerë prej 50% e shumës së përcaktuar.
Nëse seanca nuk fillon me kohë, pa fajin e avokatit mbrojtës, çdo orë e prezencës së avokatit në Gjykatë kompensohet me 40% e shumës së përcaktuar.
Pagesa për kompensim i takon vetëm në rastet kur vonesa ka qenë 30 minuta apo më shumë. Për efekt të kompensimit, koha prej 30 minuta apo më tepër llogariten si një (1) orë.³

¹ Neni 6 Lartësia e Kompensimit për shqyrtimin e shkresave paragrafi 1 dhe 2 i Udhëzimit Administrativ nr.06/2023 për procedurat për kompensimin e mbrojtësve me shpenzime publike.

² Neni 7 Lartësia e Kompensimit për përfaqësimin e të pandehurit paragrafi 1 pika 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 i Udhëzimit Administrativ nr.06/2023 për procedurat për kompensimin e mbrojtësve me shpenzime publike.

³ Neni 7 Lartësia e Kompensimit për përfaqësimin e të pandehurit paragrafi 3 dhe 4 i Udhëzimit Administrativ nr.06/2023 për

Pjesa III – Mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike⁴

Mjeti juridik	Çmimi (EUR)	Shënoni me 'y' përpilimin e aktit
Për përpilimin e ankesës kundër aktvendimit, kundërshtimit ndaj urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake, kundërshtimit të provave dhe kërkesës për hedhjen e aktakuzës, avokatit mbrojtës i takon kompensimi si në vijim:		
Për vepër penale ku parashihet dënimi deri në tri (3) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej (40) €	40	
Për vepër penale ku parashihet dënimi deri në pesë (5) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej (50) €	50	
Për vepër penale ku parashihet dënimi deri në dhjetë (10) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej (70) €	70	
Për vepër penale ku parashihet dënimi mbi dhjetë (10) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej (100) €	100	
Për përpilimin e (mjetit të jashtëzakonshëm) kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur kundër aktvendimit për caktimin apo vazhdimin e paraburgimit sipas nenit 432 paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale, avokatit i takon kompensimi si në vijim:		
Për vepër penale ku parashihet dënimi deri në dhjetë (10) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej (50) €	50	
Për vepër penale ku parashihet dënimi mbi dhjetë (10) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej (90) €	90	
Për përpilimin e ankesës kundër aktgjykimit, dhe mjeteve të jashtëzakonshme juridike kundër aktgjykimit vetëm në rastet që parashihen me nenin 56 paragrafi 1.4 të KPP, avokatit mbrojtës i takon drejta e kompensimit si në vijim:		
Për vepër penale ku parashihet dënimi deri në tri (3) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej (80) €	80	
Për vepër penale ku parashihet dënimi deri në pesë (5) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej (90) €	90	
Për vepër penale ku parashihet dënimi deri në dhjetë (10) vite burgim, i takon kompensimi në shumë prej (130) €	130	
Për vepër penale ku parashihet dënimi deri në njëzet (20) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej (150) €	150	
Për vepër penale ku parashihet dënimi mbi njëzet (20) vite burgim apo dënim me burgim të përjetshëm, i takon kompensimi në vlerë prej (160) €.	160	

Pjesa IV – Kompensimi për vizitë të pandehurit në paraburgim apo në entin shëndetësor⁵

Për vizitën e të pandehurit në paraburgim apo në entin shëndetësor, avokatit mbrojtës me shpenzime publike i takon kompensimi si në vijim:	Çmimi (EUR)	Shënoni datën e vizitës
Për vepër penale për të cilën parashihet dënimi deri në tri (3) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej (40) €	40	
Për vepër penale për të cilën parashihet dënimi deri në pesë (5) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej (50) €	50	
Për vepër penale për të cilën parashihet dënimi deri në dhjetë (10) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej (70) €	70	
Për vepër penale për të cilën parashihet dënimi deri në njëzet (20) vite burgim, i takon kompensimi në vlerë prej (100) €	100	
Për vepër penale që parashihet dënimi me burgim mbi njëzet (20) vite burgim apo dënimi me burgim të përjetshëm, i takon kompensimi në vlerë prej (150) € të shumës së përcaktuar me tarifën e Avokatëve.	150	

Shuma e përgjithshme për pagesë (mbledhja e shumave totale nga pjesa I, II, III dhe IV): _____

Emri dhe mbiemri i Gjyqtarit/Kryetarit të trupit gjykues/ Kolegjit - Nënshkrimi

Data

Formulari për kompensim i plotësuar dhe i nënshkruar sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 9, fatura valide me të dhënat sipas nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të nenit 10 nga avokati, pasi të evidentohet nga zyra e pranimit dhe me pas i dorëzohet Zyrës së Financave në Gjykatë.

Vula e Gjykatës/degës

VËREJTJE – FORMULARI DUHET TË SHTYPET NË NJË FLETË TË VETME NË TË DY FAQET, NË TË KUNDËRTËN NUK PRANOHET.

⁴ Neni 8 Lartësia e Kompensimit për përpilimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike i Udhëzimit Administrativ nr.06/2023 për procedurat për kompensimin e mbrojtësve me shpenzime publike.

⁵ Neni 9 Lartësia e Kompensimit për vizitat e të pandehurit në paraburgim apo në entin shëndetësor i Udhëzimit Administrativ